

I. Universiteti Politeknik i Tiranës shpall 2 (dy) vende pune në Institutin e Gjeoshkencave, një vend për personel akademik me kohë të plotë pranë Departamentit të Sizmologjisë dhe një vend për personel ndihmësakademik me karakter administrativ me kohë të plotë në pozicionin e specialistit IT.

A. Kandidatët për personel akademik në Departamentin e Sizmologjisë, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë mbaruar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në fushën e Matematikës /Inxhinieri Matematike dhe Informatike/Inxhinieri Matematike/Inxhinieri Fizike;
2. Nota mesatare e studimeve universitare (Bachelor dhe Master i Shkencave) të jetë mbi 8.00. Doktoratura në proces ose e përfunduar përbën përparësi.
3. Të ketë eksperiencë në përdorimin e programeve Python, Matlab, STATA;
4. Pjesëmarrje në konferenca, përbëjnë përparësi publikimet shkencore në revista brenda ose jashtë vendit;
5. Njohuri të mira të gjuhës angleze, të dokumentuar me dëshmi përkatëse, së paku niveli B2;
6. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
7. Përbën përparësi eksperiencë në punë akademike;
8. Përbëjnë përparësi rekomandimet nga personeli akademik i fakultetit/universitetit përkatës ku kandidati ka kryer studimet, me titull “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”, me datë jo më të hershme se data e daljes së njoftimit përkatës së punësimit, specifikisht të cilësuar për personel akademik me kohë të plotë në IGEO.

B. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin e IT, duhet të plotësojnë kriteret si më poshtë:

1. Të kenë mbaruar studimet Bachelor dhe Master i Shkencave në Informatikë ose fusha të përafërta;
2. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë në fushën e Teknologjisë së Informacionit;
3. Të kenë njohuri të mira në njërin nga gjuhët e BE, preferohet Anglisht;
4. Të kenë cilësi të mira etike, komunikuese dhe aftësi të punojnë në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose “DOKTOR” të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **04.03.2022** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.